



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.42/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Naki Trade” Sh.P.K., me numër të biznesit 71028437 dhe seli në Prishtinë, rr. “Agim Ramadani”, nr. 22/65, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1575/22 të datës 13.11.2023, me datë **05.03.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A., ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1575/22 të datës 13.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1575/22 të datës 13.11.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimi i debitorit “Naki Trade” Sh.P.K., me numër të biznesit 71028437 dhe seli në Prishtinë, ashtu që ka anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 304/22, i lejuar me datë 07.04.2022, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1575/22 të datës 13.11.2023.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në ankesë (*me pretendime si në përgjigjen në ankesë*) me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të refuzoj si të pabazaur dhe aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1575/22 të datës 13.11.2023 ta lë në fuqi.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A., me dt. 27.04.2022 ka paraqitur propozim për përmbartim mbi bazën e dokumenteve, përkatësisht Faturës nr. 2022/0874, e datës 01.03.2022 dhe ekstraktit nga librat e kontabilitetit (kartelës financiare) të datës 29.03.2022, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 304/2022, të datës 07.04.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që, brenda afati prej 7 ditësh nga data e pranimit të urdhrin, kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 3,744.32 për periudhën kohore 01.07.2021 deri më 01.03.2022, me kamatë prej 8%, duke filluar nga data e dorëzimit të propozimit për përmbartim e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi Privat Valdrin Beka me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr. 304/2022, të datës 07.04.2022, e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, me arsyetim se lokali ku është ushtruar veprimtaria e debitori ka qenë i mbyllur për një kohë për shkak se kreditori ka hezituuar që ti rregulloj raportet e reja kontraktuale me debitorin dhe se kontrata e vitit 2017 mbi të cilën është marr lokali me qera ka skaduar. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri mbi lejimin e përmbartimit të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabazuar dhe të pambështetura në ligj, për arsye se kreditori ka vepruar konform dispozitave ligjore me rastin e paraqitjes së propozimit për përmbartim të cilit ia ka bashkangjitur faturën dhe kartelën financiare si dokumentet të besueshme në kuptim të nenit 29 të LPP-së. Me tej, ka theksuar se në faturë është përshkruar borxhi mujor dhe shuma e përgjithshme e borxhit që debitori ka ndaj kreditorit. Ndërsa, borxhi i kërkuar për përmbushje është i periudhës prej 01.07.2021 deri më 01.03.2022 i përshkruar si në propozim dhe kartel financiare të datës 29.03.2022. Tutje, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit se kontrata mes palëve nuk është valide, duke theksuar se raporti kontraktual ka vazhduar në mënyrë të heshtur në kuptim të nenit 611 të LMD-së. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1575/22 të datës 13.11.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit "Naki Trade" Sh.P.K., me numër të biznesit 71028437 dhe seli në Prishtinë, ashtu që ka anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 304/22, i lejuar me datë 07.04.2022, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret dokumentet, mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit Përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk kanë tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit është anuluar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të faturës të lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbarrim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkalles e dytë konsideron se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt ku ka vendosur se fatura si dokument ne sajë te cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm , ngase në faturë nuk është përcaktuar qartë detyrimi i debitorit. Përkatësisht, fatura rezulton të jetë lëshuar në emër të kërkesave nga qiraja mujore për muajin Mars 2022, në vlerë pre EUR 368.54, ndërsa në faturë është paraqitur borxhit total i akumuluar në lartësi prej EUR 25,848.50, pra nuk është përcaktuar qartë detyrimi sepse nuk është pasqyruar periudha kohore për të cilën është akumuluar ky borxh, duke pas parasysh se objekt i faturës janë kërkesat nga qiraja të cilat janë natyrës periodike, ndërsa në të njëjtën faturë është pasqyruar borxhi i akumuluar, e njëjta faturë si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbarrim.

Gjykata e Shkallës së Dytë ka vlerësuar edhe ekstraktin nga librat e kontabilitetit – kartelën financiare të datës 29.03.2022, dhe konsideron se gjykata e shkallës se parë ka marrë aktvendim të drejtë duke mos e pranuar si dokument të besueshëm kartelën financiare të datës 29.03.2022 pasi që i njëjti nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, pasi që objekt i ekstraktit janë kërkesat në emër të qerasë, ndërsa në me nenin 29, paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, janë përcaktuar në mënyrë taksative se për cilat shërbime ekstraktet e verifikuara nga librat afariste përbëjnë dokument të besueshme.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga fatura, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË
K.DH.SH.II.nr.42/24 me datë 05.03.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami